

12/04/2024

HIMNI AKATHIST - QËNDRIMI I KATËRT



Sot pasdite, në kishat orthodhokse kryhet shërbesa e Himnit Akathist (himn drejtuar Hyjlindëses Mari), Qëndrimi i katërt.

Në katedralen “Ngjallja e Krishtit”, do të kryhet në orën 18:00.

Himnet karakteristike të kësaj shërbese janë: “Gëzohu o Nuse e Panusëruar” dhe “Aliluia”.

Gjatë pesë javëve të para të Kreshmës, të premtëve në mbrëmje këndohet Himni Akathist.

Në katër të premtet e para, që sivjet bien në datat dt. 22, 29 mars, 5 dhe 12 prill 2024 do të këndohet nga një Qëndrim (stancë).

Ndërsa të premtën e fundit, sivjet në dt.19 prill do të këndohet i gjithë Himni Akathist, pra të katra Qëndrimet (stancat) së bashku.

Bashkangjitur gjeni tekstin e Himnit Akathist:

<https://orthodoxalbania.org/2020/2020/05/20/himni-akathist/>